

Shqipëria ka shumë bukuri natyrore e kur ta vizitoni atë, do të thoni: pse kaq shumë për ta mësuar këtë fakt.

Shqipëria vuajti periudhën e një mbylljeje të gjatë të sistemit komunist, deri më 1991, e për këtë arsye ajo nuk ishte shumë e njohur. Por tani që kjo periudhë ka kaluar, Shqipëria më në fund po pasqyron çka gjithmonë ka ekzistuar: site të harruara arkeologjike, fshatra ku koha duket se ka ndaluar, monumente historike të perandorisë



romake e asaj osmane, jo më pak plazhet e bukur të bregdetit jugor, të cilët i gjeni shpesh edhe në guidat e revistat më prestigjioze, si [Lonely Planet](#), [The New York Times](#), etj..

Shqipëria shtrihet në Evropën Juglindore, në Perëndim të Gadishullit Ballkanik, me një sipërfaqe prej 28.748 km², me gjatësi të vijës kufitare 1094 km, nga të cilat [657 km janë vijë kufitare tokësore](#) dhe [316 km vijë bregdetare](#), si dhe [48 km janë vijë ndarëse e lumenjve dhe 73 km e liqeneve](#).

Shqipëria kufizohet në jug dhe jug-lindje me Greqinë, në veri me Malin e Zi, në perëndim me Italinë, më të cilën ndahet nga deti Adriatik dhe deti Jon, në lindje me Maqedoninë dhe në veri-lindje me Kosovën, i cili është eshë shteti i dytë në rajonin e Ballkanit me popullsi më të madhe shqiptarësh.

Tirana është zemra e Shqipërisë, kryeqyteti i saj, ku shpresat dhe ëndrrat në këtë vend të vogël rriten çdo ditë e më shumë së bashku me mirëqenien dhe argëtimin e papenguar. Qendra e këtij qyteti, karakterizohet nga ndërtesat e reja e të larta dhe pallatet e vjetra e të pikturuara; nga bulevardet e veshur me gërmadha osmane dhe bunkerë të komunizmit të kthyer në vende për të bërë fotografi.

Tirana, *kryeqyteti dinamik i vendit!*

Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë dhe njëkohësisht qendra më e madhe politike, ekonomike dhe kulturore e vendit. Ajo ndodhet në një pozicion mjaft të favorshëm në qendër të vendit e vendosur në një lartësi prej 113 metrash mbi nivelin e detit. Në perëndim deti Adriatik dhe plazhi më i madh dhe popullor i Durrësit janë vetëm 32 km larg, ndërsa në lindje mali i Dajtit 1612 metra i lartë është vetëm 26 km larg.





Si qytet Tirana është relativisht e re. Ajo është themeluar në vitin 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini, një feudal vendas i cili në këtë periudhë në vendin ku sot ndodhet monumenti i "Partizanit të Panjohur" ndërtoi një xhami, një hamam dhe një furrë të cilat ishin edhe objektet e para të qytetit të ri. Në vitin 1816 qyteti ra në dorë të familjes së Toptanëve. Ngjarja më e rëndësishme për Tiranën është 11 Shkurti i vitit 1920, kur Kongresi i Lushnjës e shpalli atë kryeqytet provizor të Shqipërisë, statusin definitiv të së cilit Tirana do ta fitonte në 1925. Mbas këtij akti qyteti pati një rritje të vazhdueshme e cila mori hov sidomos pas viteve 90. Qendra e Tiranës është projektuar nga arkitektë të njohur italiane të periudhës së Musolinit. Bulevardi i madh i Tiranës "Dëshmorët e Kombit" është ndërtuar në vitin 1930, ndërsa sheshi qendror "Skënderbeu" gjatë viteve 1928 -1929. Në vitin 1968 në kuadër të 500 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar është vendosur monumenti i tij.

Në vitin 1988 në sheshin "Skënderbeu" u vendos edhe monumenti i diktatorit Stalinist Enver Hoxha, por ai u rrëzua në 20 Shkurt 1991 nga studentët dhe populli i Tiranës. Në Tiranë ndodhen institucione të tilla si Pallati i Kongreseve, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, Pallati i Kulturës me Teatrin e Operas dhe Baletit , Sky-Tower etj., si dhe godinat qeveritare të Presidencës, Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave.

Krahas Parkut të madh në jug-lindje të qytetit Tirana ka edhe disa parqe të tjera si ai Rinia, parku pranë Parlamentit, pranë presidencës etj. Tirana është qendra kryesore në Shqipëri për organizmin e konventave, konferencave e seminareve.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/tirana/>

Durrës, ashtu siç e përshkroi Katulusi "Taverna e Adriatikut"!

Durrësi. Është qyteti i dytë i Shqipërisë për nga madhësia dhe njëkohësisht porti më i madh dhe më i rëndësishëm i vendit. Durrësi është një prej qyteteve me të vjetra të Shqipërisë me një histori të gjatë. Durrësi është themeluar në vitin 627 B.C prej kolonistëve të ardhur nga Korkyra dhe Korinthi mbi trojet e fisit ilir të Taulantëve.



Fillimisht ai është njohur me emrin Epidamnus dhe më pas Dyrrahium (sipas mitologjisë, i nipi i Epidamnit). Më pas Durrësi shndërrohet në seli të mbretërve ilire taulante, Glauk dhe me pas I të bijve të tij Monunit dhe Mytilit. Është për tu përmendur fakti që Durrësi kishte kushtetutën e vet në vitin 314 B.C. qyteti u pushtua nga Kasandri i Maqedonisë ndërsa në vitin 229 B.C. ai u pushtua nga romakët. Gjatë sundimit romak aty u ndërtuan amfiteatri, ujësjellësi etj.

Mbas rënies së perandorisë romake Durrësi njohu dyndjet barbare siç ishin ato të Alarikut të visigotëve në vitin 40 dhe më pas të Valamirit të ostrogotëve. Gjatë periudhës së perandorit bizantin Anastas me origjinë nga Durrësi në qytet u ndërtuan shumë tempuj, hipodromi dhe mure të shumtë. Gjatë shekujve 7 – 12 ai ishte porti më i rëndësishëm i Adriatikut lindor. Në vitin 1368 qyteti ra në ndikimin e princit shqiptar Karl Topia i cili u detyrua që në vitin 1386 t'ia lërë qytetin Venedikut. Këta të fundit e mbajtën qytetin për 108 vjet. Në vitin 1501 Durrësi u pushtua nga otomanët . Mbas këtij akti qyteti filloi të bjerë dhe të humbas rëndësinë.

Në prag të pavarësisë kombëtare, qyteti u pushtua nga serbët të cilët u larguan prej andej në maj 1913. Për fat të keq gjatë tërheqjes ata grabitën shumë vlera të rralla arkeologjike që sot gjenden të ekspozuara në muzeume të Beogradit.

Sot qyteti i Durrësit përbën plazhin më të madh dhe më popullor të vendit, i cili është një plazh ranor dhe i ceket, fakt i cili e bën mjaft të preferuar për pushimet e familjarëve dhe fëmijëve.




Në qytet gjenden objekte mjaft të rëndësishme të cilat përbëjnë potenciale mjaft të favorshme për turizmin kulturor siç janë: Amfiteatri i Durrësit (shiko arkeologjinë), forumi bizantin, muzeu arkeologjik ku janë të paraqitura periudhat greke dhe romake, torra Veneziane, xhamia e Fatihut, Monumenti i Rezistencës, i cili i dedikohet luftës së armatosur kundër pushtimit fashist nga Italia në 7 Prill 1939, Muzeu Etnografik etj. Qyteti nëpërmjet portit lidhet në tragete me qytetet Italiane të Barit, Ankonës dhe Triestes.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/durres/>

Berati, Qyteti në UNESCO i një mbi një dritareve!

Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P.Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P.Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar.



Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestida e lashtë, i quajtur kështu ngaqë aty banonin një fis i pellazgëve, orestët, i pari i të cilëve ishte Orest, i biri i Agamemnonit. Qyteti i mirëfilltë u themelua më 313-310 P.Kr. si qytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea nga mbreti Kassandër në kujtim të

gjeneralit mëkëmbës të Lekës së Madh. Ky është emri i parë i qytetit. Pas pushtimit romak në shek. II P.Kr. ai u quajt prej tyre Albanorum Oppidum (Fortesa e Arbërve). Në shek. V, nën perandorinë Bizantine, u përforcua dhe e ndryshoi emrin në Pulheriopolis (Qytet i bukur). I pushtuar nga bullgarët në shek. IX, u quajt Belgrad (Qytet i bardhë) – Berati i sotëm.



Në vitin 1961 Berati u shpall zyrtarisht qytet muze. Ai është qytet muze me pasuri të konsiderueshme monumentesh dhe me vlera të larmishme për nga gjinitë, të cilat përbëjnë një dëshmi të trashëgimisë kulturore, historike e artistike, të jetës e të punës, të realizuara mjeshtërisht brez pas brezi nga banorët e tij. Nga zonifikimi dhe nga përcaktimi i kategorisë së monumenteve qyteti ndahet në tri zona : zona muze,

zona e mbrojtur dhe zona e lirë.

Sot Berati trashëgon 210 objekte muzeale, nga të cilat 150 janë objekte në këmbë. Prej tyre 60 janë monumente të kategorisë së parë dhe të tjerat të kategorisë së dytë.

Në datën 8 Korrik të vitit 2008 Berati u regjistrua në Listën e UNESCO-s nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore në Konferencën e mbajtur në Kanada. Berati u vlerësua si një shembull i rrallë i arkitekturës tipike Osmane.

Kështjella ose kalaja, siç quhet nga beratasit është ndërtuar mbi kodrën shkëmbore në formë trekëndëshi, me perimetër të mureve 1440 m, me 24 kulla e me dy porta. Me themelet e saj ilire, e rindërtuar disa herë në shekujt VI, XIII, XV dhe XIX ajo është sot jo vetëm një nga kështjellat më të mëdha të banuara, por edhe një arkiv i gurtë që ofron varietete stilesh dhe kontributesh të epokave të ndryshme : ilire, romako-bizantine, shqiptare e turke. Kështjella është pjesë e legjendës së vjetër e të bukur të Tomorit dhe Shpiragut.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/berati/>

Vlora, qyteti në dy dete!

Vlora është porti i dytë i vendit dhe një prej qyteteve më të mëdhenj e të rëndësishëm të Shqipërisë. Distanca nga kryeqyteti i vendit është rreth 130 km dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” 120 km. Ky daton në antikitet që në shek. VI p.e.s. me emrin Aulona. Në qendër të qytetit, pranë Sheshit të Flamurit, janë zbuluar fragmente të mureve masive rrethuese të Aulonës. Në




vitin 1081 ky qytet ra nën sundimin Norman. Në shekullin XIV u përfshi në “Mbretërinë e Arbërisë” nën drejtimin e Balshajve (principata e Balshajve). Në vitin 1417 u pushtua nga osmanët.

Në 1812 qyteti ra në dorë të Ali Pashë Tepelenës dhe një shekull më vonë, në 28 Nëntor 1912, u bë kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur, me qeverinë e kryesuar nga Ismail Qemali. Objekte me interes në qytetin e Vlorës janë muzeu i “Pavarësisë” (i ngritur në ish-selinë e qeverisë së parë), ai i “Historisë” dhe “Etnografisë”.

Ndër objektet religjioze vlen të përmendet xhamia e Muradies e ndërtuar në vitin 1542 nga kryearkitekti i Perandorisë Otomane Mimar Sinani, (arkitekt Sinani), i cili ishte me origjinë shqiptare. Kjo xhami është e vetmja vepër e mbetur në Shqipëri nga ana e tij. Në një kodër dominante mbi qytet gjendet pika religjioze e “Kuzum Babait” objekt i sektit bektashian. Prej kësaj ofrohet një pamje e bukur dhe madhështore drejt qytetit të Vlorës, gadishullit të Karaburunit, ishullit të Sazanit dhe lagunës së Nartës. Këtu ndodhen gjithashtu bare dhe restorante të këndshme.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/vlora/>



Shkodra, kryeqyteti i Shqipërisë së Veriut, djepi i kulturës shqiptare!

Është qendra më e rëndësishme e Shqipërisë së Veriut dhe me një traditë mjaft të pasur kulturore për gjithë Shqipërinë. Ajo gëzon një pozitë mjaft të favorshme gjeografike mbasi mund të konsiderohet si “port hyrje” për në Alpet madhështore të Shqipërisë nga njëra anë dhe një pikë nga ku mund të udhëtosh për në plazhin ranor të Velipojës në detin Adriatik. Zona e Shkodrës dallohet për veçoritë e spikatura natyrore dhe për trashëgiminë e pasur kulturore.



Në këtë zonë, krahas objekteve të rëndësishme natyrore, si: liqeni i Shkodrës, lumi Buna, laguna Kune-Vaini, lumi Drin, Alpet Shqiptare, Malësia e Madhe, gjiri i Drinit etj. ndodhen edhe qytetet e rëndësishme historike, Shkodra dhe Lezha.

Potencialet turistike të zonës së Shkodrës janë të shumta, çka jep mundësi të zhvillohet ai lloj turizmi që parapëlqehet. Këtu mund të zhvillohet: Turizmi bregdetar, me përqendrim në zonën e Velipojës, e cila është vetëm 30 km larg nga Shkodra dhe në zonën e Shëngjinit, shumë afër Lezhës, të cilat kanë edhe një infrastrukturë turistike relativisht të mirë.

Turizmi liqenor, në pjesën e liqenit të Shkodrës. Turizmi malor, për klimën e shëndetshme dhe për mundësinë e ushtrimit të sporteve dimërore, që ofrojnë zona të tilla, si Razma, Boga dhe Thethi, të cilat ndodhen vetëm 46 km larg qytetit në mes të zonës së Alpeve, ku shtresa e trashë e dëborës ruhet thuhet gjatë pjesës më të madhe të vitit.

Turizmi i gjuetisë, sidomos në liqenin e Shkodrës, në deltën e lumit Buna, kompleksin turistik të Kune-Vainit në deltën e Drinit, që dallohen për biodiversitetin e larmishëm. Turizmi lumor, në gjithë rrjetin e pasur lumor dhe përrenjor të përshtatshëm për ushtrimin e sportit me kajakë. (në lumin Buna).

Turizmi kulturor, për njohjen e një numri të madh monumentesh historike dhe kulturore të dy prej qyteteve kryesore, Shkodrës dhe Lezhës, të pasura me histori shumëshekullore të çdo periudhe.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/shkodra/>

Gjirokastra, qyteti i veçantë me kështjellën më të madhe të Shqipërisë!



Gjirokastra ose Gjirokastër, është qytet në Shqipërinë jugore, banorët e të cilit quhen gjirokastritë. Qytet i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit otoman.

E vendosur në Shqipërinë jugore, Gjirokastra qëndron në shpatet e pjerrëta të luginës së lumit Drino, në një pozicion mbisundues mbi një peizazh të pasur me histori, kufijtë e të cilit përvijohen nga maja malesh të larta. Ky është “qyteti i një mijë shkallëve” që përfshin qindra shtëpi-kullë të tipit otoman me çatitë dalluese të gurta, ballkonet e drunjta dhe muret e gurta herë-herë të zbardhura me gëlqere. E mbisunduar nga ana e vet prej kalasë madhështore që ngrihet mbi një kodër të thiktë, Gjirokastra është një qytet magjik me një të shkuar të trazuar. Nga bastion i feudalizmit në xhevahir otoman e më pas në qendër e rëndësishme e pushtuesve fashistë italianë, qyteti ka njohur shumë sundimtarë dhe ka frymëzuar shumë poetë, shkrimtarë dhe artistë. Qyteti me popullsi 40 000 banorë, është qendra ekonomike e administrative e rrethit me të njëjtin emër.



Qyteti i sotëm i Gjirokastrës përfshin Qytetin e Vjetër, me kalanë (bërthama e parë e vendbanimit) dhe lagjet e tipit osman, ndërtuar mbi kreshta, që vijnë duke u larguar nga kalaja deri në tabanin e luginës, ku ndodhen ndërtimet bashkëkohore dhe kompleksi universitar. Lagjet tradicionale shtrihen në formë rrezesh rreth kalasë me emrat: Cfaqë, Dunavat, Manalat, Palorto, Varosh, Meçite, Hazmurat, Pazari i Vjetër.

Historia e hershme e qytetit është relativisht e panjohur. Për shkak të afërsisë me qendrat klasike dhe helenistike: Jerma (Antigonea) dhe qyteti romak Adrianopolis pranë fshatit Sofratikë, është menduar shpesh që vendbanimi më i hershëm në Gjirokastrë është kalaja mesjetare. Por mbi këtë tezë janë hedhur dyshime pasi zbulimet brenda në kala kanë nxjerrë në dritë qeramikë në 4 faza të ndryshme banimi përpara periudhës osmane: në shekujt V – II p.e.s., shekujt V – VII e.j., shekujt IX-X dhe shekujt XII – XIII. Më e hershmja nga këto faza solli gjurmë të një muri të konsiderueshëm ndërtuar me blloqe, gjë që bën të mendosh që ka pasur një fortifikim të rëndësishëm të periudhës para romake në këtë anë të luginës së lumit Drino (para vitit 168 p.e.s.).

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/gjirokastra-2/>

Kruja, Qyteti i heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut!

Është një prej qyteteve më historike të Shqipërisë. Ajo ndodhet në një distancë të afërt nga kryeqyteti, vetëm 32 km larg. Emri dhe rëndësia e Krujës lidhet me veprën dhe aktivitetin 25 vjeçar të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) i cili, gjatë periudhës së mesjetës në shek. e XVI e shndërroi Krujën dhe kështjellën e saj në një pikë të papërkulur rezistencë ndaj rrezikut Osman dhe duke e bërë atë të njohur dhe të famshme në të gjitha kancelaritë diplomatike të Evropës.



Emri i Krujës rrjedh nga fjala shqipe “ krua” . Në periudhën bizantine ajo përmendet si një qendër peshkopale . Rreth vitit 1190 aty u krijua i pari shtet feudal shqiptar. Më vonë ajo kaloi nën sundimin e familjes feudale shqiptare të Topiajve. Pushtimi i parë otoman ndodhi në 1396,por ata u tërhoqën për 20 vjet . Në 1430 ajo u kthye në qendër të kryengritjes Shqiptare të udhëhequr nga Gjon Kastrioti , i ati i Skënderbeut. Periudha më e lavdishme fillon në 28 Nëntorin e vitit 1443 kur kalaja e Krujës u morr në kontrollin e Gjergj Kastriotit , i cili organizoi rezistencën e gjatë anti - otomane.

Që nga kjo periudhë Kruja nën udhëheqjen e Skënderbeut theu tre rrethime të saj nga otomanët në 1450, 1457 dhe 1466. Vetëm 10 vjet mbas vdekjes së Skënderbeut në 1478 otomanët pushtuan kalanë dhe shkatërruan qytetin. Ata e quajtën Krujën Akcahisar (fortesë e bardhë). Pjesa e popullsisë që mbeti u kthye në myslimane. Sot

qyteti ngrihet në shpatin e malit të Krujës në një lartësi prej afro 600 metrash mbi nivelin e detit , duke poseduar një pamje panoramike . Nga qyteti i Krujës shikohet qartë deti Adriatik.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/kruja/>

Korça, qyteti i serenatave!

Pas Pogradecit unikal, ju pret surpriza e radhës, Korça, një nga qendrat më të mëdha urbane të Shqipërisë. Në bulevardin kryesor në pranverë, do të kënaqeni me aromën e veçantë të blinjeve, ndërsa në dimër, është kënaqësi të ecësh nën kurorën e pemëve të mbuluara me dëborë.



Në vitin 1887 në Korçë u hap e para shkollë shqipe. Në periudhën e Luftës së Parë Botërore qyteti u pushtua nga francezët dhe në këtë kohë u shpall “Krahina Autonome e Korçës”. Në vitin 1917 në këtë qytet u hap Liceu Francez, një nga shkollat më të përmendura në Shqipëri. Ajo që të bën përshtypje është arkitektura e veçantë, me shtëpitë tip vilash, rrethuar me kangjella dhe oborre të mbushura me lule të shumëllojshme. Veçanërisht mbresëlënëse do të jetë për ju zona midis bulevardit “Republika” dhe “Shën Gjergji”. Në këtë zonë ndodhet “Muzeu i Artit Mesjetar”.

“Muzeu Prehistorik” i vendosur në dy banesa karakteristike korçare do t’iu ofrojë 1200 objekte, të cilat përfaqësojnë gërmime arkeologjike nga periudha prehistorike, periudha helene, romake dhe bizantine e hershme. Me interes të veçantë është shtëpia muze e mjeshtrit të peisazhit Vangjush Mio, si dhe Muzeu i Koleksionit Bratko, i çelur në vitin 2003 me vepra të artit oriental të vendeve të Lindjes së Largët.

Objekte të tjera me interes janë: pazari i Korçës (shek. XIX dhe fillimi i shek. XX), xhamia e Iliaz Bej Mirahorit, viti 1484 (monumenti më i vjetër i qytetit), Katedralja e Ngjalljes së Krishtit (ndër më të mëdhatë në Ballkan), kisha e Shën Ilias nga ku mund të shihni nga lart qytetin etj. Në tavernat e qytetit do të gjeni një shije gatimi që nuk e keni provuar më parë. Mund të provoni shumë gjëra, por mos lini pa shijuar lakrorin me qepë e domate. Gjithashtu mos rrini pa provuar tavën e korminës.

Korça është e njohur për këngët e saj karakteristike, të quajtura “serenata” të cilat shoqërohen me kitara. Korça është qyteti i karnavaleve. Ato zhvillohen në prag të Pashkëve Orthodoxe dhe ceremonia e tyre është më madhja dhe më e bukura në Shqipëri.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/korca/>

Pogradec, qyteti i Shqipërisë në liqenin e Ohrit!

Në qytetin e Pogradecit ju do të hyni nga rruga nacionale, e cila kryqëzohet në Majën e Qafë Thanës me rrugën që vjen nga pika kufitare me të njëjtin emër, nga Maqedonia. Ju rekomandojmë që pikërisht ku kryqëzohen këto dy rrugë të mos harroni të keni me vete aparatit fotografik për të fiksuar një pamje të rrallë: Liqenin e Ohrit, një perlë e vërtetë. Pak metra më poshtë, ndaloni në gadishullin e Linit dhe në fshatin me të njëjtin emër, 25 km larg Pogradecit. Thuhet se në antikitet prindërit e perandorit Justinian e kishin Linin vendin më të pëlqyer për të pushuar.



Veç pamjes magjike, këtu mund të vizitoni mozaikun në Bazilikën e Linit mbi kodër, i cili daton në shek. VI-VII p.e.s. dhe shquhet për dekoracion të larmishëm zoomorf, floreal dhe gjeometrik. Ai ka ngjashmëri me mozaikët e Durrësit të lashtë.

Rrugës për në Pogradec kalon pranë bregut të liqenit të Ohrit, i cili me origjinën e tij tektonike dhe me thellësinë që arrin deri në 285 m, është më i thelli në Ballkan. Liqeni me moshë dy milion vjeçare, i cili për vlerat e tij unike është shpallur pasuri e UNESCO-s, ruan në gjirin e tij 17 lloje peshqish nga të cilët 70% janë endemikë dhe 30% lloje butakësh ku veçohet sfungjeri i Ohrit, i cili gjendet edhe në liqenin e Bajkalit. Buzë liqenit do të gjeni shumë restorante, bare dhe hotele komode. Shijoni peshkun dhe mënyrën e gatimit të tij tradicional dhe pikërisht tavën e famshme të Koranit, turshitë dhe "kollofacja".

Gjithashtu do të gjeni shumë lloje verërash, në veçanti verën tradicionale dhe unikale të butit, rakinë e famshme "perla" dhe "muskat" të Pogradecit. Në këtë qytet, të banuar prej periudhës së neolitit dhe më pas nga fiset Ilire të Enkelejve dhe Dasaretëve, (që kanë vënë zanafillën e qytetit me kalanë e Pogradecit, në një kodër 870 m. mbi nivelin e detit), mund të vini në çdo stinë të vitit, pasi ka një klimë të mrekullueshme. Mos u largoni nga Pogradeci pa vizituar Drilonin dhe Tushemishtin, 5 km në jug të qytetit. Ujrat që dalin nga burimet e Drilonit, formojnë një liqen tjetër të vogël. Përreth ka gjelbërim krejt të veçantë që e bën këtë vend bashkë me fshatin piktoresk të Tushemishtit, një oazë të papërsëritshëm qetësie dhe pushimi. Ju mund të preheni të lumtur në këtë park të këndshëm.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/pogradeci/>

Elbasan, qyteti në zemër të Shqipërisë!

Elbasani. Ndodhet në qendër të vendit dhe përbën qytetin e tretë të vendit për nga madhësia. Ai gjendet në një distancë prej 54km larg nga kryeqyteti dhe 82km nga porti kryesor i Durrësit. Ai ka qenë një vendbanim i lashtë në kryqëzimin e rrugëve perëndim-lindje dhe veri-jug. I njohur fillimisht me emrin “Skampa”, shek. II A.D. ai ka qenë stacioni i parë i rëndësishëm pas Durrësit në “Via Egnatia”. Më vonë është njohur me emërtimin Hiskampis dhe në vitin 509 është shfaqur si qendër peshkopate. Vendbanimi i vjetër u rrënuar nga dyndjet e barbarëve dhe në shek. XV u rishfaq me emrin Valmi.



Në vitin 1466 Sulltan Mehmeti i II duke mos arritur të marrë kalanë e Krujës e vendosi kampin e tij në fushën e Elbasanit dhe rindërtoi kalanë dhe muret e qytetit duke e quajtur atë “ILBASAN” (vend që sundon).

Elbasani i rindërtuar filloi të popullohej në shpejtësi dhe në shek. XVI u kthye në qendër sanxhaku. Gjatë historisë së tij Elbasani u kthye në një qendër mjaft të rëndësishme e arsimit kombëtar shqiptar, në vitin 1909 aty u krijua e para shkollë e mesme shqiptare “Normalja e Elbasanit”. Nga kjo krahinë janë ikonografët e famshëm shqiptar Onufri dhe Kostandin Shpataraku si dhe linguisti mjaft i rëndësishëm i gjuhës shqipe i shek. XIX Kostandin Kristoforidhi, i cili ka lindur në këtë qytet.

Objektet më të rëndësishme për tu vizituar në qytet janë kalaja (shih Kalatë), xhamia e Nazireshës, shek. XVII (është rasti i rrallë mbasi është një xhami me emër gruaje), hamami i shek. XVI, kisha e Shën Mërisë në kala, muzeu Etnografik, kulla e sahatit etj.

4 km larg nga qyteti ndodhet manastiri i Shën Gjon Vladimirit, i ndërtuar aty nga princi shqiptar Karl Topia në vitin 1382. Aty ndodhet edhe varri i tij. Pranë qytetit ndodhen llixhat të cilat janë të njohura që prej periudhës romake.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/elbasani/>

Përmet, qyteti i luleve dhe vendi i një natyre idilike!

Në Përmet do të shijoni mikpritjen, gjelbërimin dhe atmosferën e një qyteti të qetë. Gjatë verës, në Përmet do të gjeni plazhe të shumtë, në pellgje të formuara si xhepa në brigjet e Vjosës. Në restorantet brenda dhe jashtë qytetit, do të gjeni një kuzhinë tepër të veçantë dhe një shërbim



mbresëlënës. Veç gatimeve karakteristike të zarzavateve, për të cilat Përmeti është aq i përmendur, do të provoni ingjinarin e gatuar me vaj ulliri, mishin e gjahut, thëllëzën e malit mbushur me përsesh, derrin e egër, lepurin e egër, peshkun e shijshëm të Vjosës, etj. Gjithashtu do të shijoni verën (Kabërnët, Merlot, etj), rakinë e famshme tradicionale, si dhe glikotë e mrekullueshme me të gjitha llojet e frutave.

Përmeti, qyteti i luleve, trëndafilave, këngëve të pashoqe, pastërtisë dhe qetësisë, (i njohur në antikitet me emrin "Tryfilia", i banuar nga fise Ilire), njihet si qendër administrative që në shek. XV. Pazaret e tij të shumta dhe të pasura vizitoheshin nga shumë vende të tjera ballkanike. Sot ju ftojme të vizitoni "Gurin e Qytetit", një masiv shkëmbor monumental befasues, që natyra ia ka dhuruar bujarisht qytetit, për ta bërë atë krejt të veçantë. Duke vizituar kishat, veçojmë kishën e Leusës (shek. XVIII), e cila shquhet për ikonostasin, afresket, si dhe kishën e Shën Marisë në Kosinë (shek. XII). Përmeti është vendlindja e shumë artistëve të mëdhenj të panteonit shqiptar si e vëllezërve Frashëri dhe e shumë personaliteteve të tjerë të shquar të politikës, shkencës, letrave, muzikës dhe arteve figurative, që kanë vënë themelet e kombit shqiptar. Me që jemi në panteonin shqiptar, mos humbni rastin pa u ngjitur në Frashërin malor, rreth 30 km larg qytetit. Rrugës për në fshatin malor Frashër, ju do të kaloni mes për mes Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotovës, një panoramë e papërsëritshme midis bredhave dhe pishave të panumërta. Këtu ofrohen mundësi për ecje në natyrë, kamping, etj.

Lokalitete të tjera atraktive janë ujërat termale të Bënjës dhe luginës së Lengaricës që është vetëm 3 km larg qytetit. Përmeti ka gjashtë burime natyrore të hapura "outdoor", të cilat janë kurativë për sëmundje të ndryshme. Temperatura e ujërave është 26-32 gradë C dhe këto të fundit kanë veti kurative në trajtimin e stomakut, lëkurës dhe reumatizmit. Këto ujëra burojnë nga kanionet e bukura të dy urave që i përkasin kohës së Ali Pashë Tepelenës: Ura e Kaikut dhe ajo e Dashit. Teksa largohemi nga Përmeti, rruga na çon drejt kufirit grek, i cili ndodhet vetëm 30 km nga qyteti dhe drejt Leskovikut të famshëm që shquhet për ujërat termale të Vronomeros dhe banjat e avullit të Postenanit.

Gjatë verës mund të ndiqni një garë të përvitshme kanotazhi, ku lundëtarët nisen që nga Greqia fqinje, buzë maleve të Pindit nga nis rrjedhën Vjosa dhe priten me ceremoni në Përmet. Ky ritual i përvitshëm, përsëritet edhe për dy veprimtari të tjera siç janë: "Festivali Ndërkombëtar Multikulturor", i cili zhvillohet në qershor dhe "Dita e verërave" që zhvillohet në muajin maj. Gjatë këtij muaji zhvillohet edhe një takim kombëtar kushtuar figurave të shquara që kanë lindur në Frashër.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/permet/>

Apollonia, atje ku perandori August studio filozofinë!

Apollonia ndodhet 12 km larg qytetit të Fierit. Ajo u themelua në fillim të shekullit të VII-të p.e.s. nga kolonizatorët grekë që vinin nga Korinti. Të dhënat e para të pranisë së tyre janë të dokumentuara rreth vitit 588 p.e.s. Qyteti e mori emrin për nder të perëndisë Apollon.



Ndër 24 qytete në të gjithë botën mesdhetare që mbanin këtë emër në Antikitet, Apollonia e Ilirisë ishte më e rëndësishmja dhe luajti një rol të madh si ndërmjetëse tregtare mes helenëve dhe ilirëve. Apollonia ishte në atë kohë një qytet i madh e i rëndësishëm në afërsi të lumit Aoos (Vjosë). Qyteti ka pasur rreth 60.000 banorë, një shifër rekord për Antikitetin! Ai e ruajti madhësinë e tij edhe në periudhën romake. Oktavian Augusti studioi aty oratori. Territori i madh i mbuluar me monumente, peisazhet e mrekullueshme të fushës së Myzeqesë, deti Adriatik nga njëra anë dhe plazhet e jugut nga ana tjetër, e bëjnë parkun arkeologjik Apollonia lehtësisht të arritshëm për vizitorët dhe një destinacion të privilegjuar për turizmin kulturor në Shqipëri.

<http://www.akt.gov.al/al/top-destinations/apollonia/>

Për më shumë informacion: 'Visit Albania' <http://www.albania.al/sq>